



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 400-9547

Dt: 22.02.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit nr. 06-7288-11/1 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve me dt: 09.02.2016, me të cilin është miratuar propozimi i ZKKK-së për subvencionimin e aktiviteteve të OJQ "Përparimi i Komuniteteve" me rastin e shënimit të ditës ndërkombëtare të Ashkalinjëve të Kosovës, me dt: 22.02.2016 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i ZKKK-së për mbështetje financiare të OJQ "Përparimi i Komuniteteve", sipas kërkesës së evidentuar me nr. 10-400-1085 e dt: 11.01.2016, për zhvillimin e aktiviteteve për shënimin e ditës ndërkombëtare të Ashkalinjëve të Kosovës, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të ZKKK-së në vlerë prej 300€ .
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 300€, nga linja e subvencioneve të ZKKK-së dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhironlogarinë e OJQ "Përparimi i Komuniteteve" nr. 20-25-0000413035-89-Teb Bank .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .
4. Vendimi iu dërgohet :
 - Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
 - Z. Bajram Tutaj, përfaqësues i OJQ "Përparimi i Komuniteteve"
 - Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari- Lila

